



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË	
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA	
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA	
Nr./Sist. Org.	Nr. Prot.
Org. Unit	Pr. Prot.
Org. Jed.	Pr. Prot.
Nr. i Faqeve	Data
No. Pages	Data
Br. Stranica	Data
PRISHTINË - A	



Prishtinë, 03.05.2024

RAPORTI I KOMISIONIT RECENSUES

*për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:
Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shek. XX- zgjedhje/rizgjedhje*

Bazuar në konkursin e Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, të shpallur më 05.04.2024 në të përditshmen "Epoka e Re" dhe faqen zyrtare të Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, neneve 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 si dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri" nr. 01/50/20, si dhe bazuar në vendimin e datës 19.03.2024, nxjerrë nga Drejtoresha e Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, Prof. Dr. Teuta Shala Peli, Komisioni Recensues për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shek. XX - zgjedhje/rizgjedhje*, në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Skender Zhitia - kryetar, Prof. Dr. Bujar Dugolli - anëtar dhe Prof. Asoc. Dr. Fitim Rifati - anëtar, i paraqet Këshillit Shkencor këtë:

RECENSION

për kandidatin

Mbështetur në dokumentet dhe dispozitat ligjore mbi të cilat është shpallur konkursi i sipërshtuar si dhe në dosjet e kandidatëve të paraqitur, Komisioni Recensues ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor (profesor i asocuar) për shek. XX - zgjedhje/rizgjedhje*, ka konkurruar vetëm Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu, kandidat i brendshëm.

Gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit, bazuar në dispozitat ligjore të kërkuara për këtë vend pune, në mënyrë të veçantë janë shqyrtuar punimet e publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike dhe revistat vendore, botime të monografive, pjesëmarrja në sesione, konferenca, simpoziume, tryeza shkencore ndërkombëtare e kombëtare si dhe kontribute të tjera shkencore dhe profesionale të kandidatit nga thirrja e fundit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të nevojshëm të dorëzuar, të dëshmuar në CV-në e kandidatit, Komisioni Recensues ka konstatuar se kandidati Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu i plotëson kushtet formale juridike për t'iu nënshtruar procedurave të zgjedhjes për këtë vend pune.

TË DHËNA BIOGRAFIKE PËR KANDIDATIN

Skender Lutfiu u lind më 19.09.1983 në Ferizaj, Republika e Kosovës. Studimet universitare i vijoi në Universitetin në Prishtinë, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, ku u diplomua në vitin 2007. Studimet pasuniversitare i vijoi po në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë (2008-2010). Në vitin 2011 mbrojti punimin e masterit “*Bashkëpunimi kulturor-arsimor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë (1969-1980)*”. Studimet e doktoratës po ashtu i vijoi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë (2013-2019). Në vitin 2019 mbrojti tezën e doktoratës “*Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1918-1939*”. Nga 7 korriku i vitit 2020 Skender Lutfiu vijon punën në Institutin e Historisë në Prishtinë si *Bashkëpunëtor shkencor (prof. ass. dr.) për shek. XX*. Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu, sipas konkursit i ka ofruar të gjitha dëshmitë për të dhënat e ofruara në CV e tij.

AKTIVITETI KËRKIMOR-SHKENCOR DHE PROFESIONAL

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, neni 5, përkatësisht **Shtojcës I, pika A.2.1** (punime të publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike me 1) **dhe pika A.2.2** (punime të publikuara në revista kombëtare, të cilat janë të barasvlershme me 1), Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka këto punime të publikuara:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Titulli i punimit	Revista	Vëll.nr.(viti), fq.	Linku i publikimit
1.	Skender Lutfiu	<i>“The italian-jugoslav rivalry for political-economic influence in Albania 1929-1934”</i> (bashkautor me Mentor Hasanin)	EMINAK: Scientific Quarterly Journal, Modern History	Nr.4 (44), (2023), 125-147 Botuar më 2024	https://www.eminak.net.ua/index.php/eminak/article/download/679/499/
2	Skender Lutfiu	<i>“Ndikimi i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”</i>	KOSOVA	Nr.46 (2021), 105-119	

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika A. tabela 1.2** (publikime të monografive studimore, librave me dokumente, në gjuhën shqipe), Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka të botuar ose në proces botimi:

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.	Skender Lutfiu	“Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1918-1939”	Monografi	Instituti i Historisë “Ali Hadri”	Prishtinë, 2021
2.	Skender Lutfiu	“Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913)” (Vëllimi III)	Vepër me dokumente	Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë	Tiranë, 2024 (në proces të botimit)

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika B. tabela 1.1** (publikime nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore brenda dhe jashtë vendit), Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka të publikuara ose janë në proces të publikimit:

Nr.	Autori/autorët	Titulli i punimit	Konferencat, simpoziumet	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), fq.
1.	Skender Lutfiu (bashkëautor me Mentor Hasanin)	“Ballafaqimet ideopolitike në parlamentin shqiptar për laicizimin e shtetit dhe emancipimin e gruas 1920-1924”	Konferencë shkencore ndërkombëtare “Parlamentarizmi shqiptar ndër vite”	Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik, Prishtinë	Nr.XXXII (2021), 127-153
2.	Skender Lutfiu	“Shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Mbretëria e Jugosllavisë dhe vendosja e tyre në Monarkinë shqiptare faktor determinues në raportet midis dy vendeve (1928-1939)”	Konferencë shkencore “Shqipëria mes dy Luftërave Botërore: aspekte të politikës, të së drejtës dhe shoqërisë shqiptare në vitet 1925-1939”	Instituti i Historisë (ASA), Tiranë	(2024), (në proces të botimit)

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika B. tabela 1.2** (publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendor), Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka të publikuara ose janë në proces të publikimit:

Nr.	Autori/autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), fq.
1.	Skender Lutfiu	<i>“Krimet e forcave serbe në komunën e Ferizajt, të Kaçanikut, të Shtimes dhe të Shtërpcës (1998-1999)”</i>	“Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek.XIX-XX”	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë	(2024), 413-446
2.	Skender Lutfiu	<i>“Çështja e përcaktimit të kufirit verilindor të Shqipërisë sipas raporteve të konsujve austro-hungarezë”</i>	“Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)”	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë	(2023), (në proces të botimit)

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika C. tabela 1.4** (kontribute tjera shkencore dhe profesionale), Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka këto kontribute:

Nr.	Autori/autorët	Lloji i kontributit shkencor	Vendi dhe viti
1.	Skender Lutfiu	Recensent i veprës me dokumente “Letërkëmbimet e panjohura të Faik Bej Konicës 1897-1900”, Vëllimi I dhe II	Prishtinë, 2020
2.	Skender Lutfiu	Recensent profesional i librit të <i>Historisë për klasën e tetë (8)</i>	Prishtinë, 2021
3.	Skender Lutfiu	Recensent profesional i librit të <i>Historisë për klasën e nëntë (9)</i>	Prishtinë, 2022
4.	Skender Lutfiu	Anëtar i redaksisë i veprës “Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë”, Vëllimi I dhe II,	Prishtinë, 2021
5.	Skender Lutfiu	Anëtar i Këshillit redaktues i veprës “Katalog - botimet e Institutit të Historisë (1967-2022)”	Prishtinë, 2022
6.	Skender Lutfiu	Recensent i veprës “ <i>Rrethanat socio-ekonomike në Shqipëri 1912-1939</i> ”	Prishtinë, 2023
7.	Skender Lutfiu	Recensent i veprës “ <i>Përmbledhje kumtesash për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë</i> ”	Prishtinë, 2023

8.	Skender Lutfiu	Recensent i veprës "Ferizaj në dokumentet osmane 1873-1912"	Ferizaj, 2024
9.	Skender Lutfiu	Recensent i veprës me dokumente "Marrëdhëniet jo zyrtare: Shtetet e Bashkuara dhe Qeveria revolucionare në Shqipëri – 1924"	Prishtinë, 2024 (në proces të botimit)

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika D. tabela 1.1** (pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore), Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka këto kontribute të tjera shkencore dhe profesionale:

Nr.	Programi/projekti shkencor	Periudha kohore	Pozicioni në projekt	Institucioni dhe vendi
1.	Historia e Kosovës	Në proces	Studiues	Instituti i Historisë - Prishtinë
2.	Drenica në fokusin e Historisë	Në proces	Studiues	Instituti i Historisë - Prishtinë
3.	Monografia "Ferizaj"	Në proces	Kryeredaktor	Instituti i Historisë - Prishtinë

KONKLUZION

Mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet e konkursit, të shpallur më 05.04.2024, në të përditshmen "Epoka e Re", si dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), në Statutin e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë dhe Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri", Komisioni Recensues ka arritur në këtë konkluzion:

Marrë në konsideratë rezultatet e punës shkencore, përgatitjen adekuate mbi periudhën e kërkuar në konkurs, punimet shkencore të fushës përkatëse të botuara në revista relevante, botimin e monografisë shkencore, pjesëmarrjen në aktivitete, konferenca e tryeza shkencore brenda e jashtë vendit, kontributet shkencore si dhe përvojën e krijuar brenda Institutit të Historisë "Ali Hadri", Komisioni Recensues ka arritur në përfundimin se kandidati Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu ka të arritura dhe kontribute shkencore të profilizuara për periudhën e caktuar, kualifikimin dhe përvojën e duhur, që i mundësojnë zgjedhjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së punës sipas pozitës së kërkuar në konkurs.

PROPOZIM

Komisioni Recensues, bazuar në kushtet e konkursit, kriteret ligjore dhe të arriturat profesionale, për vendin e punës **Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shek. XX** në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, propozon kandidatin Prof. Ass. Dr. Skender Lutfiu.

Komisioni Recensues:

Prof. Asoc. Dr. Skender Zhitia, *kryetar*

Prof. Dr. Bujar Dugolli, *anëtar*

Prof. Asoc. Dr. Fitim Rifati, *anëtar*

